



Prishtinë, 24 Qershor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_635_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6, Nenin 25 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);dhe
- Vendimin nr.V_631_2014 për të Hyrat E Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar);
- Vendimin e KOSTT nr. V_633_2014 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A (KOSTT);
- Vendimin e OSSH nr.V_634_2014 për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);dhe
- Aplikacionin e KEDS të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE8) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 24 Qershor 2014 nxori këtë:**

V E N D I M

- I. **APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mblidhen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të aplikohen nga **Furnizuesi Publik me energji Elektrike(KEDS)**, për vitin relevant tarifor apo SHTE8 (2014-2015), i cili fillon nga 1 prilli 2014 .



ARSYETIM


- ✚ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar nga KEDS-Divizioni i Furnizimit aplikacionin për aprovim të Të Hyrave të Lejuara Maksimale, që do të mblidhen nga Furnizuesi Publik, nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
 - ✚ Në marrjen e vendimit të tij për të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Furnizuesi Publik, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi i përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Gjatë periudhës shkurt-maj 2014 janë mbajtur takime dhe konsultime për të sqaruar aplikacionin e të licencuarëve për tarifa;
 - Raporti përfundimtar- Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 Qershor 2014; dhe
 - Raporti përfundimtar -Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPEE), i publikuar më datën 24 Qershor 2014.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga i licencuari për Furnizim Publik me energji elektrike për vitin relevant tarifor SHTE 8 janë 239,965,097 euro. Vlerësimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale janë të paraqitura në Raportet përfundimtarë për FPEE dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Furnizuesit Publik do t'i llogariten të hyrat e lejuara maksimale në bazë të azhurnimeve vjetore të parapara me Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike.
- IV. Furnizuesi Publik përmes këtij Vendimi udhëzohet t'i përgatis dhe dorëzoj ZRRE-së propozimin për aprovim të tarifës së rregulluar me pakicë, brenda një afati sa më të shkurtë.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve të përkthyer , do të mbizotëroj versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE


Enver Halimi, Kryesues


Merita Kostari, Anëtar


Krenar Bujupi, Anëtar